



Tryeza Diskutuese: “Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës – një vit pas hyrjes në fuqi”

Me 16 korrik 2021, një vit nga hyrja në fuqi e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës në Kosovë, Save the Children në Kosovë dhe Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit organizuan tryezën diskutuese “Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës – një vit pas hyrjes në fuqi”, e cila u mbajt në Prishtinë, për të shënuar në mënyrë ceremoniale këtë datë dhe reflektuar mbi përgjegjësinë dhe angazhimin reciprok mes bartësve të detyrave dhe shoqërisë civile për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës.

Kjo tryezë u organizua në kuadër të projektit “Fuqizimi i Organizatave Lokale të Shoqërisë Civile 2017-2021” implementuar nga Save the Children në Kosovë dhe mbështetur nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Projekti ka për qëllim fuqizimin e organizatave lokale dhe rajonale të shoqërisë civile dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve përmes krijimit të sistemeve të përgjegjshme për Mbrojtjen e Fëmijës dhe përmes mbështetjes së mekanizmave dhe sistemeve për Qeverisje me të Drejtat e Fëmijës.

Qëllimi i tryezës ishte diskutimi i përbashkët mes bartësve të detyrave dhe institucioneve përgjegjëse, grupeve të udhëhequra nga fëmijët, shoqërisë civile dhe palëve të tjera lidhur me implementimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës deri më tani. Zbatimi i mekanizmave parandalues dhe reagues ndaj të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijës, koordinimi ndër-sektorial për ofrim të shërbimeve cilësore dhe miqësore për fëmijë, si dhe rëndësia e analizave buxhetore në planifikim të këtyre shërbimeve kishin fokus të veçantë diskutimi.

DISKUTIMI NË PANEL

Tryeza u hap nga përfaqësuesja e grupit të fëmijëve 'Respect our Rights – ROR', themeluar me mbështetjen e Save the Children në Kosovë. Puhiza Shemsedini, kryetare e grupit ROR, shprehu nga perspektiva e fëmijëve rëndësinë që ka zbatimi i Ligjit në mirëqenien, mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre. Ajo shprehu se masat për mbrojtjen e fëmijës në Kosovë nuk zbatohen në nivel të kënaqshëm, duke ngritur shembuj konkret të rasteve të shkeljes së të drejtave të tyre. Ndër këto raste, ajo përmendi mos ofrimin e qasjes në institucionet edukative për fëmijët me aftësi të kufizuara; rastet e shpeshta të dhunës brenda shkollave edhe nga mesimdhënësit; mungesën e mekanizmave funksional për adresimin e rasteve të dhunës; cënueshmërinë e fëmijëve lëmshëkërkues; mungesën e prioritizimit të shëndetit mendor të fëmijëve, sidomos gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.

Paneli diskutues ishte i përbërë nga përfaqësues të institucioneve kyçe përgjegjëse për implementimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, sikurse Zyra për Qeverisje të Mirë; Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticion, Kuvendi i Republikës së Kosovës; Institucioni i Avokatit të Popullit; Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; përfaqësues të shoqërisë civile si Save the Children në Kosovë dhe OJQ Syri i Vizionit.

PROGRESI DERI NJË VIT PAS HYRJES NË FUQI TË LIGJIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

- 📌 Me koordinim të ZQM-së, 17 akte nënligjore që derivojnë nga Ligji janë në finalizim;
- 📌 Shoqëria civile, përfshirë Save the Children në Kosovë, OJQ lokale dhe nacionale, është duke kontribuar me ekspertizë tematike dhe mbështetje financiare për draftimin e këtyre akteve nënligjore;
- 📌 ZQM, së bashku me akterët të shoqërisë civile, respektivisht OJQ partnere të Save the Children në Kosovë, është duke e dizajnuar strategjinë për "Fushatën Nacionale për Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës", e cila do të lansohet në shtator 2021;
- 📌 Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar raste të dhunës ndaj fëmijëve dhe ka hartuar rekomandime për institucionet;
- 📌 Organizatat e shoqërisë civile, respektivisht "Syri i Vizionit", "Advocacy Training and Resource Center (TRC)", "Down Syndrome Kosova", "Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror (OFAP)" - OJQ partnere të Save the Children, po vazhdojnë koordinimin për promovimin e Ligjit në komunitetet në nivel lokal.

SFIDAT EKZISTUESE

- 📌 Buxheti i dedikuar për zbatimin e Ligjit është tejet i vogël dhe duhet të jetë i bazuar në një analizë të mirëfilltë;
- 📌 Pjesa e konsiderueshme e popullatës dhe ofruesve të shërbimeve, siç janë mësimmshënësist dhe punëtorët social, sidomos në vende rurale, nuk kanë njohuri të mjaftueshme për ekzistimin e Ligjit;
- 📌 Mungojnë grantet për skema sociale që të fuqizohen Qendrat për Punë Sociale në nivel komunal që të avansojnë ofrimin e shërbimeve sociale/ për mbrojtjen e fëmijëve;
- 📌 Mungon një analizë e përgjithshme dhe koordinim ndër-ministoror për të vënë prioritetet /hapat konkret drejt zbatimit të Ligjit;
- 📌 Komunat nuk kanë buxhet të mjaftueshëm për të vënë në prioritet zbatimin e Ligjit.

HAPAT E RADHËS DHE REKOMANDIMET

- 📌 Në muajin tetor 2021 bëhet rishikimi i buxhetit shtetëror për vitin 2021. Institucionet përgjegjëse duhet të identifikojnë resurset financiare të nevojshme për zbatim të Ligjit dhe t'i drejtohen Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticion;
- 📌 Të prioritzohet dhe avokohet fuqishëm krijimi i Grantit Specifik për shërbime sociale i cili do të rriste buxhetin për implementimin e Ligjit;
- 📌 Të krijohet një Grant Specifik shtesë për nivelet komunale për implementimin e ligjit;
- 📌 Ligji parasheh themelimin e Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijës.
- 📌 Pas hyrjes në fuqi të akteve nënligjore lidhur me Ligjin të organizohet takim ndër-ministoror;
- 📌 Të mirret parasysh pjesëmarrja e fëmijëve në proceset vendimarrëse, si shumë e rëndësishme pasi që do të reflektonte më së miri adresimi i nevojave reale;
- 📌 Fushatat për promovimin e Ligjit të shtrihen edhe në vendet rurale, ku gjendja e dhunës ndaj fëmijëve është më e rënduar.